

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TRAVELTALES ALBANIA LIMITED” Sh.p.k.

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot, më 21.02.2023 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: “**TRAVELTALES ALBANIA LIMITED**” Sh.p.k.

1.2 Themeluesit e shoqërisë janë:

- GIANNOS KONSTANTINOS, shtetas Grek, me date lindje: 09.10.1950, identifikuar me numer pasaporte: AT1623641.
- FRABINA BERZESHTA, shtetase Greke, me date lindje: 07.11.1994, identifikuar me numer pasaporte AT2931863.

Neni 2

Objekti

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetet në vijim:

Te themeloje dhe te shfrytezoje, te promovoje zyra te turizmit te per gjithshem, te ndertoje godina, te organizoje dhe te shfrytezoje aktivitete turistike, hoteleri, bujtina, zyra turistike, marketing turistik, konferanca, ekspozita, botime turistike si brenda dhe jashtë vendit. Te shfrytezoje automjete me qera dhe mjete te tjera te argetimit detar dhe tokesor, sherbime shkembimi dhe kontrata bashkëpunimi. Te ofroje sherbime turistike per kompani te ndryshme brenda dhe jashtë vendit, te perfaqesoje kompani dhe brande nepermjet te drejtës se pordorimit. Te kryeje investime te cdo lloje natyre financiare, shitje, blerje, kembim, qera dhe nen qera te cdo lloje pasurie te pa luajtshme dhe te luajtshem, te drejta, koncesione, licensa, mallra te cdo lloj natyre. Sherbime konsulencje, importe dhe eksport te per gjithshme. Te punesoje, te marre me qera, te trajnoje personelin profesional te zyrave turistike. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe jelohet nga ligji, qe lidhet direkt ose indirekt, rrjedh apo ka te beje me objektivat e saj.

Neni 3

Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të përcaktuar.

Neni 4

Selia

4.1 Selia e shoqërisë do te jete ne adresën: Tirane, Rruga Abdi Toptani, Godina Torre Drin, Kati 2, Kodi postar 1001.

Kreu II
Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë i paguar është 100,000 (njeqind mijë) Lekë te reja. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- Ortaku themelues: GIANNOS KONSTANTIONOS Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesedhjet mijë) Lekë që përbën 50 % të kapitalit themeltar të

shoqërisë.

- Ortaku themelues: FRABINA BERZESHTA Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesedhjet mijë) Lekë që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

- 6.1 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 6.2 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet pa kufi, në çdo moment, një ose disa herë. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.3 Në të gjitha rastet zvogelimi kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.


KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE


Neni 8

Organë Vendimmarres

- 8.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te peraktuara ne ligj.
- 8.3 Asambleja e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e Administratorit/ve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i Likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratorit/ve;
 - gi) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë se Ortakeve;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



2



8.4 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve

9.1 Asambleja e Ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet me poste te regjistruar të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

9.2 Kur asambleja e e Ortakëve nuk është thirrur sipas pikës 9.1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, e Asamblese se Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51 për qind të kuotave.

10.2 Në rastin kur Asambleja e Ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht.

10.3 Nëse Asambleja e Ortakëve nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

11.1 Asambleja e Ortakëve vendos me dy të tretat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.2 Asambleja e Ortakëve vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ve;
- c) emërimin e shkarkimin i Likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

11.3 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Biznesit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Neni 13

Administrimi

13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte deri ne 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqeria do te drejtohet nga 2 Administratore, te cilet Jane dhe ortaket e shoqerise.

- 13.2 Administratori i Shoqerise per një afat 5 vjecar do te jetë: Z. GIANNOS KONSTANTINOS, shtetas Grek, me date lindje: 09.10.1950, identifikuar me numer pasaporte: AT1623641.

Specimeni i nënshkrimit te administratorit eshte si vijon:

- 13.2.1 Administratori i Shoqerise per një afat 5 vjecar do te jetë: Znj. FRABINA BERZESHTA, shtetase Greke, me date lindje: 07.11.1994, identifikuar me numer pasaporte AT2931863.

Specimeni i nënshkrimit te administratorit eshte si vijon:

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

14.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) hapë llogari bankare në emrin e shoqërisë dhe të administrojë/kryejë veprime me këte/këto llogari bankare së bashku dhe vetem me nënshkrimin e autorizuar të ortakut themelues të shoqërisë.
- ç) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; dhe përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërçenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.2 Administratori është i detyruar të therasë Asamblene e Pergjithshme, në rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

14.3 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

- 15.1 Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e

marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

15.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

15.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me

15.4. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 15.1 e 15.2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkura. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

15.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9901 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

15.6 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

15.7 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV Viti finanziar-ekspertet

Neni 16



Viti Financiar

16.1 Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

17.1 Eksperti ka detyre të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimitarë ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.



17.2 Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergaatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja–riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

18.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njostuar pezullimi i veprimitarise në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper".

18.2 Prishja e shoqërise tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

18.3 Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 20

Baza Ligjore

20.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

21.1 Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKET THEMELUES

"TRAVELTALES ALBANIA LIMITED" Sh.p.k.
GIANNOS KONSTANTINOS

KONSTANTINOS GIANNOS
GJYK

FRABINA BERZESHTA

Frabina Bërzeshëta
F. Bërzeshëta